



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM
Nr. 2, Dt. 25.09.2008

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit uJOR, lumi Shushice, per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-it qe do te ngrihet ne Hore-Vranisht, prej subjektit "Shushica Union" sh.p.k. Vlore.

Ne plotesim te kerkeses te bere, prej subjektit "Shushica Union" sh.p.k. dhe ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-se nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik", te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Miratimin ne parim te kerkeses, "**Per dhenien me koncension**", te burimit uJOR, lumi Shushice , (ne afersi te fshatit Kallarar), per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Shushica Union" sh.p.k, Vlore, me veper marrje ne vendin me koordinata:
 $X = 44\ 52\ 900$ $Y = 43\ 94\ 900$ $Z = 266.5\ M$
2. Sasia e ujit qe mund te jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete $Q = 4\ m^3/sek.$
3. Periudha e perdorimit te ujerave, do te jete gjate gjithë vitit, perjashto, periudhen nga 01.05. deri me 31.08, ku sasise te mesiperme do ti zbritet sasia $0.5\ m^3/sek$, qe do te perdoret per ujitje e kulturave bujqesore.
4. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyne ne fuqi, pas procedurave te konkurimit, dhe miratimit te kontrates te koncesionit nga M.E.T.E dhe K.M-se.

KRYETAR I K.B.U "VJOSE"
Hasan HALILI

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

VeZir METAJ

